



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 162

19 dhjetor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 112/2012 datë 22.11.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin shtesë të Nagoja-Kuala Lumpurit “Për përgjegjësi dhe dëmshpërblim të protokollit të Kartagenës për biosigurinë” të konventës së biodiversitetit	8695
Ligj nr. 113/2012 datë 22.11.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin e Nagojës “Për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë e të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i tyre” të konventës së biodiversitetit “Për larminë biologjike”	8702
Ligj nr. 114/2012 datë 7.12.2012	Për një ndryshim në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”	8719
Vendim i Kuvendit nr. 47/2012, datë 15.11.2012	Për numërtimin e legjislaturave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë	8720
Vendim i Kuvendit nr. 48/2012, datë 22.11.2012	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar	8721
Vendim i Kuvendit nr. 49/2012, datë 7.12.2012	Mbi dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Adriatik Llalla Prokuror i Përgjithshëm	8722

LIGJ
Nr. 112/2012

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN SHITESË TË
NAGOJA-KUALA LUMPURIT “PËR PËRGJEGJËSI DHE DËMSHPËRBLIM TË
PROTOKOLLIT TË KARTAGJENËS PËR BIOSIGURINË” TË KONVENTËS
SË BIODIVERSITETIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin shtesë të Nagoja-Kuala Lumpurit “Për përgjegjësi dhe dëmshpërblim të protokollit të Kartagjenës për biosigurinë” të konventës së biodiversitetit, sipas tekstit bashkëlidhur.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.11.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7858, datë 11.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

NAGOJA-KUALA LUMPUR
PROTOKOLL SHITESË
MBI PËRGJEGJËSINË DHE DËMSHPËRBLIM TË PROTOKOLLIT TË KARTAGJENËS
PËR BIOSIGURINË

Sekretariati i Konventës mbi Diversitetin Biologjik, Montreal
Kombet e Bashkuara
[Logo]

Sekretariati i Konventës për Diversitetin Biologjik
Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara
413 rruga “West St Jacques”, Suite 800
Montreal, Quebec, 1N9 H2Y Kanada
Telefon: +1 (514) 288 2220
Faks: +1 (514) 288 6588
E-mail: secretariat@cbd.int
Web Site: www.cbd.int and bch.cbd.int/protocol
© 2011 nga Sekretariati i Konventës për Diversitetin Biologjik
Të drejtat e rezervuara Al. Botuar 2011
Shtypur në Kanada



ISBN: 92-9225-324-7

Ky publikim mund të riprodhohet për qëllime arsimore apo jofitimprurëse pa leje të veçantë të autorit, me kusht njohjen e burimit. Sekretariati i konventës do ta vlerësojë marrjen e një kopjeje të publikimit që e përdor këtë dokument si burim.

Regjistrim katalogu lokal:

Nagoja-Kuala Lumpur protokoll shtesë mbi përgjegjësinë dhe dëmshpërblim të protokollit të Kartagenës për biosigurinë/sekretariati i Konventës për Diversitetin Biologjik

Përmbledhje: “Kjo broshurë përmban protokollin shtesë mbi përgjegjësinë dhe dëmshpërblim të protokollit të Kartagenës për biosigurinë në Nagoja-Kuala Lumpur” - Siguruar botuesit

ISBN: 92-9225-324-7

1. Biodiversiteti-ligji dhe legjislacioni. 2. Ligji ndërkombëtar i mjedisit. 3. Biodiversiteti-bashkëpunimi ndërkombëtar. 4. Bioteknologji.

I. Konventa mbi Diversitetin Biologjik (1992), protokollet etj.; 15 tetor 2010. II. Konferenca e palëve të Konventës për Diversitetin Biologjik shërben si takim i palëve për protokollin e Kartagenës mbi biosigurinë (2010: Nagoja, Japoni). III. Kombet e Bashkuara.

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni sekretariatit e Konventës për Diversitetin Biologjik

Hyrje

Protokollin e Kartagenës për biosigurinë është miratuar më 29 janar 2000, si një marrëveshje shtesë e Konventës për Diversitetin Biologjik. Ai hyri në fuqi më 11 shtator 2003. Protokollin është një marrëveshje mjedisore shumëpalëshe që ka për qëllim kontributin në transferimin e sigurt, trajtimin dhe përdorimin e organizmave të gjallë të modifikuar, që mund të kenë efekte negative mbi shumëllojshmërinë biologjike, duke marrë, gjithashtu, parasysh rreziqet për shëndetin e njeriut dhe me fokus të veçantë në lëvizjet ndërkufitare.

Çështja e përpunimit të rregullave mbi përgjegjësinë dhe dëmshpërblimin për dëmet që rezultojnë nga organizmat e gjallë të modifikuar, ka qenë duke u shqyrtuar ndërkombëtarisht, si para ashtu dhe pas miratimit të protokollit mbi biosigurinë. Neni 27 i protokollit vendosi bazat për krijimin e një procesi formal drejt përfundimit të shqyrtimit të çështjes brenda një afati kohor të përcaktuar. Neni 27 i kërkoi konferencës së palëve të Konventës mbi Diversitetin Biologjik, që shërben si takim i palëve për biosigurinë, të miratojë protokollin në mbledhjen e saj të parë, një proces në lidhje me hartimin e duhur të rregullave ndërkombëtare dhe procedurave në fushën e përgjegjësisë dhe dëmshpërblimit për dëmet që rezultojnë nga lëvizjet ndërkufitare të organizmave të gjallë të modifikuar.

Prandaj, takimi i parë i konferencës së palëve që shërben si takim i palëve për protokollin e Kartagenës mbi biosigurinë, e cila u mbajt në Kuala Lumpur në datat 23-27 shkurt 2004, themeloi një grup specifik pune të përbërë nga ekspertë ligjorë mbi përgjegjësinë dhe dëmshpërblimin në kontekstin e protokollit të Kartagenës për biosigurinë, të analizojnë çështjet, mundësitë dhe të propozojnë rregullat ndërkombëtare dhe procedurat mbi këtë temë.

Pas disa vitesh negociatash, një marrëveshje ndërkombëtare, e njohur si Nagoja-Kuala Lumpur protokollin shtesë mbi përgjegjësinë dhe dëmshpërblimin e protokollit të Kartagenës mbi biosigurinë, u përfundua dhe u miratua nga Nagoja, Japoni, më 15 tetor 2010 në takimin e pestë të konferencës së palëve që shërben si takim i palëve për protokollin.

Protokollin shtesë miraton qasje administrative për të adresuar përgjigje në rast të dëmtimit ose mundësi të mjaftueshme të dëmtimit të ruajtjes dhe të përdorimit të qëndrueshëm të diversitetit biologjik që rezultojnë nga organizmat e gjallë të modifikuar që gjejnë origjinin e tyre në lëvizjet ndërkufitare.

Ashtu si traktati mëmë, protokollin e Kartagenës për biosigurinë, miratimi i protokollit shtesë në Kuala Lumpur është parë si një funksion për parandalimin e dëmeve në njërin anë dhe si një masë e mëtejshme për krijimin e besimit nga ana tjetër, në zhvillimin dhe zbatimin e bioteknologjisë moderne. Ajo avancoi mjedisin për të derivuar përfitime maksimale nga potenciali i organizmave të gjallë të modifikuar, duke ofruar rregulla për rishqyrtim ose përgjigje në rast se diçka shkon keq dhe biodiversiteti vuan apo ka të ngjarë të vuajë dëmet.

NAGOJA-KUALA LUMPUR
PROTOKOLL SHITESË
MBI PËRGJEGJËSINË DHE DËMSHPËRBLIM TË PROTOKOLLIT TË KARTAGJENËS
PËR BIOSIGURINË

Palët në këtë protokoll shtesë,
duke qenë palë në protokollin e Kartagjenës për biosigurinë të konventës mbi Diversitetin Biologjik, referuar më poshtë si “protokollit”;
duke marrë parasysht parimin 13 të deklaratës së Rios për mjedisin dhe zhvillimin;
duke ripohuar masat mbrojtëse të përfshira në parimin 15 të Deklaratës së Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin;
duke njohur nevojën për të siguruar përgjigjen e duhur aty ku ka dëmtim ose dëme të ngjashme, në përputhje me protokollin;
duke përmendur nenin 27 të protokollit,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Objektivi

Objektivi i këtij protokollit shtesë është që të kontribuojë në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të shumëllojshmërisë biologjike, duke marrë, gjithashtu, parasysht rreziqet për shëndetin e njeriut, duke ofruar rregulla ndërkombëtare dhe procedura në fushën e përgjegjësisë dhe dëmshpërblimit në lidhje me organizmat e gjallë të modifikuar.

Neni 2
Përdorimi i termave

1. Termat e përdorur në nenin 2 të Konventës për Diversitetin Biologjik, më poshtë referuar si “konventa” dhe neni 3 i protokollit duhet të zbatohet mbi këtë protokoll shtesë.
2. Përveç kësaj, për qëllime të këtij protokollit shtesë:
 - a) “Konferenca e palëve që shërben si takim i palëve të protokollit” do të thotë konferenca e palëve të konventës që shërben si takim i palëve të protokollit;
 - b) “Dëmtimi” do të thotë një efekt negativ në ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të shumëllojshmërisë biologjike, duke marrë, gjithashtu, parasysht rreziqet për shëndetin e njeriut, që:
 - i) është e matshme ose ndryshe e dukshme, duke marrë parasysht, kur është e disponueshme, bazën shkencore të themeluar dhe të njohur nga një autoritet kompetent që merr parasysht çdo ndryshim tjetër njerëzor dhe ndryshim natyral; dhe
 - ii) është i rëndësishëm, siç është përcaktuar në paragrafin 3 më poshtë;
 - c) “Operator” është çdo person në kontroll të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të organizmave të gjallë të modifikuar, i cili mund, kur është e përshtatshme dhe e përcaktuar nga ligji i brendshëm të përfshijë, ndër të tjera, bartësin e lejes, personin, i cili e vendos organizmin e gjallë të modifikuar në treg, zhvilluesin prodhues, eksportuesin, importuesin, transportuesin ose furnizuesin;
 - d) “Masat e reagimit” do të thotë veprimet e arsyeshme:
 - i) për të parandaluar, minimizuar, zbutur ose ndryshe, për të shmangur dëmin, sipas nevojës;
 - ii) për të rikuperuar diversitetin biologjik me veprimet që duhen marrë sipas rendit të preferencës së mëposhtme:
 - a) rikuperimi i shumëllojshmërisë biologjike në gjendjen që ka ekzistuar para dëmit të ndodhur ose ekuivalenten e saj më të afërt dhe ku autoriteti kompetent përcakton që kjo nuk është e mundur;
 - b) rikuperimi, ndër të tjera, duke zëvendësuar humbjen e diversitetit biologjik me kompetentë të tjerë të larmisë biologjike, për të njëjtën gjë apo për një përdorim tjetër në vendndodhjen aktuale apo sipas rastit në ndonjë vend tjetër.



3. Një efekt “i rëndësishëm” duhet të përcaktohet në bazë të faktorëve, të tillë si:
- ndryshim afatgjatë ose i përhershëm, duhet kuptuar si ndryshim që nuk do të rregullohet nëpërmjet rimëkëmbjes natyrore brenda një periudhe të arsyeshme kohe;
 - shkallën e ndryshimeve cilësore apo sasiore që të ndikojë negativisht në komponentët e diversitetit biologjik;
 - ulja e aftësisë së komponentëve të larmisë biologjike për të siguruar mallra dhe shërbime;
 - masa e çdo efekti negativ mbi shëndetin e njeriut në kontekstin e protokollit.

Neni 3 Qëllimi

1. Ky protokoll plotësohet vlen për dëmtimet që rezultojnë nga organizmat e gjallë të modifikuar, të cilët e kanë origjinën e tyre nga lëvizjet ndërkufitare. Organizmat e gjallë të modifikuar të përmendur janë këta:

- të destinuar për përdorim të drejtpërdrejtë si ushqim apo për përpunimin;
- të destinuar për një përdorim të limituar;
- të destinuar për futjen e qëllimshme në mjedis.

2. Në lidhje me lëvizjet ndërkufitare të qëllimshme, ky protokoll shtesë aplikohet për dëmtime që rezultojnë nga përdorimi i autorizuar i organizmave të gjallë të modifikuar, përmendur në paragrafin 1 më sipër.

3. Ky protokoll shtesë vlen edhe për dëmtimet jo të qëllimshme, si pasojë e lëvizjeve ndërkufitare referuar në nenin 17 të protokollit, si dhe dëmtimet që rezultojnë nga lëvizjet ndërkufitare të paligjshme, siç referohet në nenin 25 të protokollit.

4. Ky protokoll shtesë vlen për dëmtimet që rezultojnë nga lëvizjet ndërkufitare të organizmave të gjallë të modifikuar, që filloi pas hyrjes në fuqi të këtij protokollit shtesë për palën në juridiksionin e së cilës janë bërë lëvizjet ndërkufitare.

5. Ky protokoll shtesë zbatohet për dëmet që kanë ndodhur në zonat brenda kufijve të juridiksionit kombëtar të palëve.

6. Palët mund të përdorin kriteret e përcaktuara në ligjin e tyre të brendshëm për të trajtuar dëmet që janë shkaktuar brenda kufijve të juridiksionit të tyre kombëtar.

7. Ligji vendor për zbatimin e këtij protokollit shtesë duhet të zbatohet edhe për dëme që rezultojnë nga lëvizjet ndërkufitare të organizmave të gjallë të modifikuar nga palët joanëtare.

Neni 4 Shkaku

Një lidhje e rastësishme duhet të vendoset midis dëmit dhe organizmave të gjallë të modifikuar në përputhje me ligjin vendas.

Neni 5 Masat e reagimit

1. Palët duhet të kërkojnë nga operatori ose operatorët, në rast të dëmtimit, subjekt i të gjitha kërkesave të autoritetit kompetent:

- për të informuar menjëherë organin kompetent;
- për të vlerësuar dëmin; dhe
- për të marrë masat e duhura të reagimit.

2. Autoriteti kompetent:

- duhet të identifikojë operatorin që ka shkaktuar dëmin;
- duhet të vlerësojë dëmin; dhe
- duhet të përcaktojë masat që duhet të merren nga operatori

3. Kur informacioni i rëndësishëm, duke përfshirë informacionin shkencor ose informacionin në dispozicion të Zyrës së Kleringut të Biosigurisë, tregon se ka mundësi të mjaftueshme që të ketë dëmtim, në qoftë se nuk merren masa në kohë, operatorit duhet t'i kërkohet të marrë masat e duhura për të shmangur dëme të tilla.

4. Autoriteti kompetent mund të zbatojë masat e duhura, në veçanti kur operatori ka dështuar ta bëjë këtë.

5. Autoriteti kompetent ka të drejtë që të tërheqë nga operatori kostot e shpenzimeve dhe sipas rastit vlerësimin e dëmit dhe zbatimin e masave të përshtatshme. Palët mund të parashikojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm, situata të tjera, në të cilat operatorit nuk mund t'i kërkohet mbajtja e kostove dhe shpenzimeve.

6. Vendimet e autoritetit kompetent që i kërkojnë operatorit të marrë masat për reagim duhet të jenë të arsyetuara. Vendimet e tilla duhet t'i njoftohen operatorit. Ligji vendor duhet të sigurojë mjete, duke përfshirë edhe mundësinë për rishikim administrativ ose gjyqësor të vendimeve të tilla. Organi kompetent duhet, gjithashtu, në përputhje me ligjin e brendshëm, të informojë operatorin për mjetet ligjore në dispozicion. Mbështetja në mjete të tilla nuk duhet të pengojë autoritetet kompetente që të marrin masa në rrethanat e duhura, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga ligji i brendshëm.

7. Në zbatim të këtij neni dhe me qëllimin e përcaktimit të masave specifike të reagimit që do të kërkohen apo do të merren nga autoriteti kompetent, palët, sipas rastit, vlerësojnë nëse masat janë trajtuar me ligjet e tyre vendase mbi përgjegjësinë civile.

8. Masat do të zbatohen në përputhje me ligjin vendas.

Neni 6 **Përfshirjet**

1. Palët mund të parashikojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm, përfshirjet e mëposhtme:

- a) aktin e fuqisë së mbinatyrshe ose forcën madhore; dhe
- b) aktin e luftës apo trazirave civile.

2. Palët mund të parashikojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm, përfshirje të tjera ose zbutje që ata i konsiderojnë të arsyeshme.

Neni 7 **Afatet kohore**

Palët mund të parashikojnë në legjislacionin e tyre vendas, për:

- a) afatet kohore relative ose absolute, duke përfshirë veprime të lidhura me masat; dhe
- b) fillimin e periudhës për të cilën aplikohet kufizimi.

Neni 8 **Kufizjtë financiarë**

Palët mund të parashikojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm, kufizimin financiar për mbulimin e shpenzimeve dhe shpenzimet që lidhen me masat e reagimit.

Neni 9 **E drejta e veprimit**

Ky protokoll shtesë nuk duhet të kufizojë ndonjë të drejtë veprimi ose dëmshpërblimi që një operator mund të ketë ndaj ndonjë personi tjetër.



Neni 10 Siguria financiare

1. Palët ruajnë të drejtën për të ofruar, në të drejtën e tyre të brendshme, siguri financiare.
2. Palët duhet të ushtrojnë të drejtën e përmendur në paragrafin 1 më sipër në një mënyrë të qëndrueshme me të drejtat dhe obligimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar, duke marrë parasysh tre paragrafët e fundit të hyrjes së protokollit.
3. Takimi i parë i konferencës së palëve që shërben si takim i palëve për protokollin pas hyrjes në fuqi të protokollit shtesë kërkon që nga sekretariati të ndërmerret një studim i plotë, i cili duhet të adresojë ndër të tjera:
 - a) mënyrën e mekanizmave të sigurisë financiare;
 - b) vlerësimin e ndikimeve mjedisore, ekonomike dhe sociale të mekanizmave të tillë, në mënyrë të veçantë në vendet në zhvillim; dhe
 - c) identifikimin e subjekteve të përshtatshme për të ofruar sigurinë financiare.

Neni 11 Përgjegjësia e shteteve për aktet ndërkombëtare të gabuara

Ky protokoll shtesë nuk duhet të ndikojë të drejtat dhe detyrimet e shteteve nën rregullat e ligjit ndërkombëtar të përgjithshëm në lidhje me përgjegjësinë e shteteve për aktet ndërkombëtare të gabuara.

Neni 12 Zbatimi dhe lidhja me përgjegjësinë civile

1. Palët duhet të sigurojnë, në ligjin e tyre të brendshëm, rregulla dhe procedura që adresojnë dëmin. Për të zbatuar këtë detyrim, palët ofrojnë për masat e reagimit në përputhje me këtë protokoll plotësues dhe mund, sipas rastit:
 - a) të zbatojnë ligjet e tyre ekzistuese të brendshme, duke përfshirë, kur është e zbatueshme, rregullat e përgjithshme dhe procedurat mbi përgjegjësinë civile;
 - b) të zbatojnë ose të zhvillojnë rregulla civile për këtë qëllim; ose
 - c) të zbatojnë ose të zhvillojnë një kombinim të të dyjave.
2. Palët duhet, me qëllimin e ofrimit të rregullave dhe procedurave adekuate në ligjin e tyre të brendshëm mbi përgjegjësinë civile për dëmet materiale apo personale të lidhura me dëmin e përcaktuar në nenin 2 paragrafi 2 (b):
 - a) të vazhdojnë të zbatojnë ligjin e tyre ekzistues mbi përgjegjësinë civile;
 - b) të zhvillojnë dhe të zbatojnë ose të vazhdojnë të zbatojnë ligjin mbi përgjegjësinë civile specifikisht për atë qëllim; ose
 - c) të zhvillojnë dhe të zbatojnë ose të vazhdojnë të zbatojnë një kombinim të të dyjave.
3. Gjatë zhvillimit të përgjegjësisë civile, siç përmendet në nënparagrafët (b) ose (c) të paragrafëve 1 ose 2 më sipër, palët sipas rastit adresojnë, ndër të tjera, këto elemente:
 - a) dëmtimin;
 - b) standardin e përgjegjësisë, duke përfshirë përgjegjësinë bazë apo të rreptë;
 - c) kanalizimi i përgjegjësisë, kur është e përshtatshme;
 - d) e drejta për të sjellë pretendimet.

Neni 13 Vlerësimi dhe rishikimi

Konferenca e palëve që shërben si takim i palëve të protokollit duhet të ndërmarrë një shqyrtim të efektivitetit të këtij protokollit shtesë, pesë vjet pas hyrjes në fuqi dhe çdo pesë vjet pas kësaj, të ofrojë informacion të tillë që kërkon një rishqyrtim nga palët. Rishikimi do të ndërmerret në kontekstin e vlerësimit dhe të shqyrtimit të protokollit, siç përcaktohet në nenin 35 të protokollit, përveç nëse

vendoset ndryshe nga palët në këtë protokoll shtesë. Rishikimi i parë do të përfshijë një rishikim të efektivitetit të neneve 10 dhe 12.

Neni 14

Konferenca e palëve që shërben si takim i palëve të protokollit

1. Duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 32 të konventës, konferenca e palëve që shërben si takim i palëve të këtij protokollit do të shërbejë si takim i palëve të këtij protokollit shtesë.

2. Konferenca e palëve që shërben si takim i palëve për protokollin, duhet të mbajë në vëzhgim të rregullt zbatimin e këtij protokollit shtesë dhe duhet të marrë, brenda mandatit të tij, vendimet e nevojshme për të promovuar zbatimin efektiv të tij. Ajo do të kryejë funksionet e caktuara nga ky protokoll shtesë dhe funksionet e caktuara nga paragrafët 4 (a) dhe (f) të nenit 29 të protokollit.

Neni 15

Sekretariati

Sekretariati i themeluar nga neni 24 i konventës duhet të shërbejë si sekretariat i këtij protokollit shtesë.

Neni 16

Marrëdhëniet me konventën dhe protokollin

1. Ky protokoll shtesë duhet të plotësojë protokollin dhe nuk duhet, as ta modifikojë dhe as ta ndryshojë atë.

2. Ky protokoll shtesë nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet e palëve për këtë protokoll shtesë në bazë të konventës dhe protokollit.

3. Përveç kur parashikohet ndryshe në këtë protokoll shtesë, dispozitat e konventës dhe të protokollit, duhen të zbatohen pikë më pikë për këtë protokoll shtesë.

4. Pa paragjykuar paragrafin 3 më sipër, ky protokoll plotësues nuk do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet e ndonjë pale sipas së drejtës ndërkombëtare.

Neni 17

Nënshkrimi

Ky protokoll shtesë duhet të jetë i hapur për nënshkrim nga palët e protokollit pranë shtabit të Kombeve të Bashkuara në Nju- Jork nga data 7 mars 2011 deri më 6 mars 2012.

Neni 18

Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll shtesë duhet të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të dyzetë të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit nga shtetet ose organizatat e integritit ekonomik rajonal që janë palë të këtij protokollit.

2. Ky protokoll shtesë duhet të hyjë në fuqi për një shtet apo organizatat e integritit ekonomik rajonal që e ratifikojnë, e pranojnë ose e miratojnë atë apo aderojnë në të pas depozitimit të instrumentit të dyzetë, siç përmendet në paragrafin 1 më sipër, në ditën e nëntëdhjetë, pas datës në të cilën ai shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, ose në datën në të cilën protokollin hyn në fuqi për atë shtet ose organizatë rajonale të integritit ekonomik, cilado që do të jetë më vonë.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2 më sipër, çdo instrument i depozituar nga një organizatë e integritit ekonomik rajonal nuk do të llogaritet si shtesë e atyre të depozituara nga shtetet anëtare të këtyre organizatave.



Neni 19
Rezervat

Në këtë protokoll shtesë nuk mund të bëhen rezerva.

Neni 20
Tërheqja

1. Në çdo kohë pas dy vjetësh nga data në të cilën ky protokoll shtesë ka hyrë në fuqi për një palë, kjo palë mund të tërhiqet nga ky protokoll shtesë, duke dhënë një njoftim me shkrim te depozituesi.
2. Çdo tërheqje e tillë do të bëhet një vit pas datës së marrjes nga depozituesi ose në një datë të mëvonshme, siç mund të specifikohet në njoftimin e palës që po tërhiqet.
3. Çdo palë që tërhiqet nga protokollin në përputhje me nenin 39 të protokollit do të konsiderohet si e tërhequr prej këtij protokollin shtesë.

Neni 21
Tekste autentike

Originali i këtij protokollin shtesë, i cili në gjuhën arabe, kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle është autentik, duhet të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesi i autorizuar për këtë qëllim ka nënshkruar këtë protokoll shtesë. Bërë në Nagoja, më pesëmbëdhjetë tetor dy mijë e dhjetë.

[logo]

Shtypur në Rolland Enviro100 Print, e cila përmban 100% fibër postkonsumi, është zgjedhje mjedisore, pa klorinë dhe prodhuar në Kanada nga kaskadat, duke përdorur energjinë e biogazit.

Maj 2011

ISBN: 92-9225-324-7

LIGJ
Nr. 113/2012

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN E NAGOJËS “PËR AKSESIN NË BURIMET GJENETIKE DHE NDARJEN E DREJTË E TË BARABARTË TË PËRFITIMEVE QË LINDIN NGA PËRDORIMI I TYRE” TË KONVENTËS SË BIODIVERSITETIT “PËR LARMINË BIOLOGJIKE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin e Nagojës “Për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë e të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i tyre” të konventës së biodiversitetit “Për larminë biologjike”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.11.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7859, datë 11.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

PROTOKOLLI I NAGOJËS

**PËR AKSESIN NË BURIMET GJENETIKE DHE NDARJEN E DREJTË DHE TË BARABARTË TË
PËRFITIMEVE QË LINDIN NGA PËRDORIMI I TYRE, SIPAS KONVENTËS PËR DIVERSITETIN
BIOLOGJIK**

TEKSTI DHE ANEKSI

**SEKRETARIATI I KONVENTËS PËR DIVERSITETIN BIOLOGJIK
MONTREAL**

**Konventa për Diversitetin Biologjik
Kombet e Bashkuara**

Sekretariati i Konventës për Diversitetin Biologjik

Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara

413 St. Jacques Street West, Suite 800

Montreal, Quebec, Kanada H2Y 1N9

Tel: +1(514)288 2220

Faks: +1(514)288 6588

E-mail: sekretariat@cbd.int

Faqja e internetit: www.cbd.int

Botuar në vitin 2011-03-25

Për informacion të mëtejshëm, ju lutemi kontaktoni Sekretariatit e Konventës për Diversitetin Biologjik

Hyrje

Konventa për Diversitetin Biologjik u hap për nënshkrim më 5 qershor 1992 në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin ("Samiti i Tokës" i Rios) dhe hyri në fuqi më 29 dhjetor 1993. Konventa është instrumenti i vetëm ndërkombëtar që trajton në mënyrë gjithëpërfshirëse diversitetin biologjik. Tre objektivat e konventës janë ruajtja e diversitetit biologjik, përdorimi i qëndrueshëm i komponentëve të tij dhe ndarja e drejtë dhe e barabartë e përfitimeve që lindin nga përdorimi i burimeve gjenetike.

Për ta çuar më tej implementimin e objektivit të tretë, Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm (Johanesburg, shtator 2002) bëri thirrje për negociimin e një regjimi ndërkombëtar, brenda kuadrit të konventës, për të promovuar dhe ruajtur ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i burimeve gjenetike. Konferenca e konventës së palëve u përgjigj në mbledhjen e saj të shtatë, në vitin 2004, duke mandatur grupin e saj të punës të posaçëm pa afat për aksesin dhe ndarjen e përfitimit që të përpunojë dhe negociojë një regjim ndërkombëtar për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e përfitimit, në mënyrë që të implementohet efektisht neni 15 (aksesi në burimet gjenetike) dhe 8 (j) (njohuritë tradicionale) të konventës dhe tre objektivat e saj.

Pas gjashtë vitesh negociata, u miratua në mbledhjen e dhjetë të konferencës së palëve më 29 dhjetor 2010 në Nagojë, Japoni protokollin e Nagojës për aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i tyre sipas Konventës për Diversitetin Biologjik.



Protokolli çonte më tej në mënyrë të rëndësishme objektivin e tretë të konventës, duke krijuar një bazë të fortë për siguri dhe transparencë ligjore më të madhe, si për ofruesit edhe për përdoruesit e burimeve gjenetike. Detyrimet specifike për mbështetjen e përputhshmërisë me legjislacionin e brendshëm apo kërkesat rregullatore të palës që ofron burimet gjenetike dhe detyrimet kontraktuale të pasqyruara në termat për të cilët është rënë dakord në mënyrë reciproke janë një novacion i rëndësishëm i protokollit. Këto dispozita të përputhshmërisë, si dhe dispozitat që përcaktojnë kushte më të parashikueshme për aksesin në burimet gjenetike do të kontribuojnë për sigurimin e ndarjes së përfitimeve dhe kur burimet gjenetike largohen nga pala që i ofron burimet gjenetike. Veç kësaj, dispozitat e protokollit për aksesin në njohuritë tradicionale të mbajtura nga komunitetet indigjene dhe vendore kur shoqërohen me burime gjenetike do të forcojnë aftësinë e këtyre komuniteteve për të përfituar nga përdorimi i njohurive, novacionit dhe praktikave të tyre.

Duke promovuar përdorimin e burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale të lidhura me to dhe duke forcuar mundësitë për një ndarje të drejtë dhe të barabartë të përfitimeve nga përdorimi i tyre, protokollin do të krijojë stimujt për ruajtjen e diversitetit biologjik, përdorimin e qëndrueshëm të komponentëve të tij dhe do të rrisë më tej kontributin e diversitetit biologjik për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien njerëzore.

PROTOKOLLI I NAGJËS

PËR AKSESIN NDAJ BURIMEVE GJENETIKE DHE NDARJEN E DREJTË DHE TË BARABARTË TË PËRFITIMEVE QË LINDIN NGA PËRDORIMI I TYRE SIPAS KONVENTËS PËR DIVERSITETIN BIOLOGJIK

Palët e këtij protokollin,

duke qenë palë në Konventën e Diversitetit Biologjik, që këtej e tutje quhet “konventa”;

duke rikujtuar që ndarja e drejtë dhe e barabartë e përfitimeve që lindin nga përdorimi i burimeve gjenetike është një nga tre objektivat thelbësorë të konventës, dhe duke njohur që ky protokoll ndjek implementimin e këtij objekti brenda konventës;

duke riafirmuar të drejtat sovrane të shteteve mbi burimet e tyre natyrore dhe sipas dispozitave të konventës;

duke rikujtuar më tej nenin 12 të konventës;

duke njohur kontributin e rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm arritur nga transferimi i teknologjisë dhe bashkëpunimi për të ndërtuar kapacitetet e kërkimit dhe novacionit për t’u shtuar vlerë burimeve gjenetike në vendet në zhvillim, në përputhje me nenin 16 dhe 19 të konventës;

duke njohur se ndërgjegjësimi publik për vlerën ekonomike të ekosistemeve dhe biodiversitetit dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të kësaj vlere ekonomike me kujdestarët e biodiversitetit janë stimuj kyç për ruajtjen e diversitetit biologjik dhe përdorimin e qëndrueshëm e komponentëve të tij;

duke pranuar rolin potencial të aksesit dhe ndarjes së përfitimit për të kontribuar në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të diversitetit biologjik, çrrënjosjen e varfërisë dhe qëndrueshmërinë mjedisore dhe në këtë mënyrë duke kontribuar në arritjen e qëllimeve të zhvillimit të mijëvjeçarit;

duke pranuar lidhjen midis aksesit në burimet gjenetike dhe ndarjes së drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i këtyre burimeve;

duke njohur rëndësinë e garantimit të sigurisë ligjore në lidhje me aksesin në burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i tyre;

duke njohur më tej rëndësinë e promovimit të barazisë dhe drejtësisë në negociimin e termave, të rënë dakord reciprokisht midis ofruesve dhe ofruesve të përdorimeve gjenetike;

duke njohur, gjithashtu, rolin jetësor që gratë luajnë në aksesin dhe ndarjen e përfitimit dhe afirmimin e nevojës për pjesëmarrjen e plotë të grave në të gjitha nivelet e politikëbërjes dhe implementimin për ruajtjen e biodiversitetit;

të vendosur për të mbështetur më tej implementimin efektiv të dispozitave për aksesin dhe ndarjen e fitimit të konventës;

duke njohur se kërkohet një zgjidhje novatore për të trajtuar ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që rrjedhin nga përdorimi i burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale që lidhen me burimet gjenetike që kryhen në situata transkufitare ose për të cilat nuk është e mundur të jepet ose të merret pëlqimi i informuar paraprakisht;

duke njohur rëndësinë e burimeve gjenetike për sigurinë e ushqimit, shëndetit publik, ruajtjen e biodiversitetit, dhe zbutjen dhe adaptimin me ndryshimin e klimës, duke njohur natyrën e veçantë të biodiversitetit bujqësor, tipareve të tij të dallueshme dhe problemeve që kanë nevojë për zgjidhje të dallueshme;

duke njohur ndërvarësinë e të gjitha vendeve në lidhje me burimet gjenetike për ushqimin dhe bujqësinë, si dhe natyrën e tyre të veçantë dhe rëndësinë për arritjen e sigurisë ushqimore në mbarë botën dhe për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë në kontekstin e zbutjes së varfërisë dhe ndryshimit të klimës dhe duke njohur rolin thelbësor të Traktatit Ndërkombëtar për Burimet Gjenetike të Bimëve për Ushqim dhe Bujqësi dhe Komisionit FAO për Burimet Gjenetike për Ushqim dhe Bujqësi në këtë drejtim;

të vëmendshëm për rregulloret ndërkombëtare të shëndetit (2005) të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe për rëndësinë e sigurimit të aksesit ndaj patogjeneve njerëzore për përgatitjen e shëndetit publik dhe për qëllime të reagimit;

duke pranuar punën në vazhdim në forume të tjera ndërkombëtare në lidhje me aksesin dhe ndarjen e fitimit;

duke rikujtuar sistemin shumëpalësh të aksesit dhe ndarjes së përfitimit të krijuar me Traktatin Ndërkombëtar për Burimet Gjenetike të Bimëve për Ushqimin dhe Bujqësinë të zhvilluar në harmoni me konventën;

duke njohur se instrumentet ndërkombëtare të lidhura me aksesin dhe ndarjen e përfitimit duhet të mbështesin në mënyrë reciproke me synimin për arritjen e objektivave të konventës;

duke rikujtuar rëndësinë e nenit 8 (j) të konventës që lidhet me njohuritë tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i këtyre njohurive;

duke shënuar marrëdhënien midis burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale, natyrën e tyre të pandashme për komunitetet indigjene dhe vendore, rëndësinë e njohurive tradicionale për ruajtjen e diversitetit biologjik dhe përdorimin e qëndrueshëm të komponentëve të tij dhe për mjetet e qëndrueshme të jetesës së këtyre komuniteteve;

duke njohur diversitetin e rrethanave në të cilat mbahen dhe zotërohen njohuritë tradicionale të lidhura me burimet gjenetike nga komunitetet indigjene dhe vendore;

të kujdesshëm se është e drejta e komuniteteve indigjene dhe vendore për të identifikuar mbajtësit e duhur të njohurive të tyre tradicionale të lidhura me burimet gjenetike brenda komuniteteve të tyre;

duke njohur më tej rrethanat unike ku mbahen njohuritë tradicionale të lidhura me burimet gjenetike në vendet, që mund të jenë gojore, të dokumentuara ose në forma të tjera, që pasqyrojnë një trashëgimi të pasur kulturore relevante për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të diversitetit biologjik;

duke shënuar Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Popujve Indigjenë; dhe

duke afirmuar se asgjë në këtë protokoll nuk do të konceptohet sikur zvogëlon apo shuan të drejtat ekzistuese të komuniteteve indigjene dhe vendore,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij protokoll është ndarja e drejtë dhe e barabartë e përfitimeve që lindin nga përdorimi i burimeve gjenetike, duke përfshirë aksesin e duhur në burimet gjenetike dhe transferimin e përshtatshëm të teknologjive përkatëse, duke marrë parasysh të gjitha të drejtat mbi këto burime dhe teknologjitë, dhe me financimin e duhur, duke kontribuar kështu në ruajtjen e diversitetit biologjik dhe përdorimin e qëndrueshëm të komponentëve të tij.



Neni 2

Përdorimi i termave

Për këtë protokoll do të aplikohen termat e përcaktuar në nenin 2 të konventës. Veç kësaj, për qëllimet e këtij protokoll:

- a) “Konferenca e palëve” do të thotë konferenca e palëve në konventë;
- b) “Konventa” do të thotë Konventa për Diversitetin Biologjik;
- c) “Përdorimi i burimeve gjenetike” do të thotë kryerja e kërkimeve dhe e zhvillimit për përbërjen gjenetike dhe/ose biokimike të burimeve gjenetike, duke përfshirë aplikimin e bioteknologjisë për to, siç përcaktohet në nenin 2 të konventës;
- d) “Bioteknologji”, siç përcaktohet në nenin 2 të konventës, do të thotë çdo aplikim teknologjik që përdor sistemet biologjike, organizmat e gjallë, ose derivatat e tyre, për të bërë ose modifikuar produktet ose proceset për përdorim specifik;
- e) “Derivativ” do të thotë një kompozitë biokimike që ndodh në mënyrë të natyrshme duke ardhur nga shprehja gjenetike ose metabolizmi i burimeve biologjike ose gjenetike edhe nëse nuk përmban njësi funksionale të trashëgimisë.

Neni 3

Objekti

Ky protokoll do të aplikohet për burimet gjenetike brenda objektit të nenit 15 të konventës dhe për përfitimet që lindin nga përdorimi i këtyre burimeve. Ky protokoll do të aplikohet edhe për njohuritë tradicionale të lidhura me burimet gjenetike brenda objektit të konventës dhe për përfitimet që lindin nga përdorimi i këtyre njohurive.

Neni 4

Marrëdhëniet me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare

1. Dispozitat e këtij protokoll nuk do të ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e çdo pale që rrjedhin nga ndonjë marrëveshje ekzistuese ndërkombëtare, me përjashtim kur ushtrimi i këtyre të drejtave dhe detyrimeve do të shkaktoje një dëm serioz ose kërcënim për diversitetin biologjik. Ky paragraf nuk synon të krijojë një hierarki midis këtij protokoll dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare.
2. Asgjë në këtë protokoll nuk do t'i ndalojë palët që të zhvillojnë dhe të zbatojnë marrëveshje të tjera përkatëse ndërkombëtare, duke përfshirë aksesin tjetër të specializuar dhe marrëveshjet e ndarjes së përfitimit, me kushtin që ato të mbështesin dhe të mos bien ndesh me objektivat e konventës dhe këtij protokoll.
3. Protokollin do të zbatohet me mbështetje reciproke të instrumenteve të tjera ndërkombëtare që lidhen me këtë protokoll. I duhet dhënë vëmendja e duhur punës dhe praktikave vazhduese të dobishme dhe relevante sipas këtyre instrumenteve ndërkombëtare dhe organizatave ndërkombëtare përkatëse, me kushtin që ato të mbështesin objektivat e konventës dhe protokollit dhe të mos bien ndesh me to.
4. Ky protokoll është instrumenti për implementimin e aksesit dhe dispozitave të ndarjes të përfitimit të Konventës. Aty ku aplikohet aksesin ndërkombëtar i specializuar dhe instrumenti i ndarjes së përfitimit që është në përputhje me objektivat e konventës dhe këtë protokoll dhe nuk bie ndesh me to, ky Protokoll nuk do të aplikohet për palën ose palët e instrumentit të specializuar në lidhje me burimin gjenetik specifik të mbuluar nga instrumenti i specializuar ose për qëllimin e tij.

Neni 5

Ndarja e drejtë dhe e barabartë e përfitimit

1. Në përputhje me nenin 15, paragrafët 3 dhe 7 të konventës, përfitimet që lindin nga përdorimi i burimeve gjenetike, si dhe aplikimet pasuese dhe komercializimi do të ndahen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë me palën që ofron këto burime që është vendi i origjinës së këtyre burimeve ose një palë që i

ka përfituar burimet gjenetike në përputhje me konventën. Kjo ndarje do të jetë me terma për të cilët bihet dakord në mënyrë reciproke.

2. Secila palë do të marrë masa legjislative, administrative ose politike, si të jetë më e përshtatshme, me synimin që të sigurohet që përfitimet që lindin nga përdorimi i burimeve gjenetike të cilat mbahen nga komunitetet indigjene dhe vendore, në përputhje me legjislacionin vendas në lidhje me të drejtat e vendosura të këtyre komuniteteve indigjene dhe vendore mbi këto burime gjenetike, ndahen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë me komunitetet në fjalë, bazuar në terma për të cilët bihet dakord në mënyrë reciproke.

3. Për implementimin e paragrafit 1 më sipër, secila palë do të marrë masa legjislative, administrative ose politike, si të jetë e përshtatshme.

4. Përfitimet mund të përfshijnë përfitime monetare dhe jo monetare, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar me ato që renditen në aneks.

5. Secila palë do të marrë masa legjislative, administrative apo politike si të jetë e përshtatshme, në mënyrë që përfitimet që lindin nga përdorimi i njohurive tradicionale që lidhen me burimet gjenetike të ndahen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë me komunitetet indigjene dhe vendore që i mbajnë këto njohuri. Kjo ndarje do të bëhet me terma për të cilët bihet dakord në mënyrë reciproke.

Neni 6

Aksesi në burimet gjenetike

1. Në ushtrimin e të drejtave sovraane mbi burimet natyrore dhe duke iu nënshtruar aksesit të brendshëm dhe legjislacionit për ndarjen e përfitimit ose kërkesave rregullatore, aksesit në burimet gjenetike për përdorimin e tyre do t'i nënshtrohet pëlqimit paraprak të informuar të palës që ofron këto burime që është vendi i origjinës së këtyre burimeve ose të palës që i ka përfituar burimet gjenetike në përputhje me konventën, përjashtuar rasti kur është vendosur ndryshe nga ajo palë.

2. Në përputhje me ligjin e brendshëm, secila palë do të marrë masat e përshtatshme, me synimin për të siguruar që të merret pëlqimi apo miratimi i informuar paraprak dhe përfshirja e komuniteteve indigjene dhe vendore për aksesin në burimet gjenetike ku ata kanë të drejtën e vendosur për të dhënë akses në këto burime.

3. Sipas paragrafit 1 më sipër, secila palë që kërkon pëlqim paraprak të informuar do të marrë masat e nevojshme legjislative, administrative apo politike, si të jetë e përshtatshme:

a) Që të parashikojnë sigurinë ligjore, qartësinë dhe transparencën e aksesit të tyre të brendshëm dhe legjislacionin apo kërkesat rregullatore për ndarjen e përfitimit;

b) Që të parashikojnë rregulla dhe procedura të drejta dhe joarbitrare për aksesin në burimet gjenetike;

c) Që të parashikojnë se si duhet aplikuar informacioni për pëlqimin paraprak të informuar;

d) Që të parashikojnë një vendim me shkrim të qartë dhe transparent nga një autoritet kompetent kombëtar, me kosto efektive dhe brenda një periudhe kohore të arsyeshme;

e) Që të parashikojnë lëshimin e një leje ose ekuivalentit të saj në kohën e aksesit si provë e vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak të informuar dhe për vendosjen e termave të rënë dakord reciprokisht, dhe për të njoftuar përkatësisht Zyrën Qendrore të Aksesit dhe të ndarjes së përfitimit;

f) Aty ku është e aplikueshme, dhe duke iu nënshtruar legjislacionit të brendshëm, të përcaktohen kritere dhe/ose procese për marrjen e pëlqimit ose miratimit paraprak të informuar dhe përfshirjes së komuniteteve indigjene dhe vendore për aksesin në burimet gjenetike; dhe

g) Për të vendosur rregulla dhe procedura të qarta për të kërkuar dhe për të vendosur termat e rënë dakord në mënyrë reciproke. Këta terma do të vendosen me shkrim dhe mund të përfshijnë, mes të tjerash:

i) një klauzolë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

ii) termat për ndarjen e përfitimit, duke përfshirë lidhjen me të drejtat e pronës intelektuale;

iii) termat për përdorimin pasues të palës së tretë, nëse ka; dhe

iv) termat për ndryshimet e qëllimit, aty ku është e aplikueshme.



Neni 7

Aksesi në njohuritë tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike

Në përputhje me ligjin e brendshëm, secila palë do të marrë masat, si të jetë e përshtatshme, me synimin për të siguruar që për njohuritë tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike, që mbahen nga komunitetet indigjene dhe vendore, të ketë akses me pëlqimin ose miratimin e informuar paraprak dhe përfshirjen e këtyre komuniteteve indigjene dhe vendore dhe që të jenë vendosur termat për të cilët është rënë dakord në mënyrë reciproke.

Neni 8

Konsiderata të veçanta

Në zhvillimin dhe implementimin e aksesit dhe legjislacionit apo kërkesave rregullatore për ndarjen e përfitimit, secila palë:

a) do të krijojë kushtet për të promovuar dhe inkurajuar kërkimin, i cili kontribuon në ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të diversitetit biologjik, veçanërisht në vendet në zhvillim, edhe me masa të thjeshtuara për aksesin për qëllimet kërkimore jokomerciale, duke marrë parasysh nevojën për të trajtuar një ndryshim të qëllimit për këtë kërkim;

b) do t'u kushtohet vëmendja e duhur rasteve të emergjencave aktuale apo eminente që kërcënojnë ose dëmtojnë shëndetin njerëzor, të kafshëve ose të bimëve siç përcaktohet në planin kombëtar ose ndërkombëtar. Palët mund të marrin në konsideratë nevojën për akses të shpejtë në burimet gjenetike dhe ndarjen e shpejtë të drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i këtyre burimeve gjenetike, duke përfshirë aksesin në trajtimet e përbalueshme nga njerëzit në nevojë, veçanërisht në vendet në zhvillim;

c) do të konsiderojë rëndësinë e burimeve gjenetike për ushqimin dhe bujqësinë dhe rolin e tyre specifik për sigurinë e ushqimit.

Neni 9

Kontributi për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm

Palët do të inkurajojnë përdoruesit dhe ofruesit për përfitimet e drejtpërdrejta që lindin nga përdorimi i burimeve gjenetike drejt ruajtjes së diversitetit biologjik dhe përdorimit të qëndrueshëm të komponentëve të tij.

Neni 10

Mekanizmi global shumëpalësh i ndarjes së përfitimit

Palët do të konsiderojnë nevojën dhe modalitetet për një mekanizëm global shumëpalësh për ndarjen e përfitimit që të trajtojë ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i burimeve gjenetike dhe i njohurive tradicionale të shoqëruara me burime gjenetike që ndodhin në situatat transkufitare ose për të cilat nuk është e mundur të jepet ose të merret pëlqimi paraprak i informuar. Përfitimet e ndara nga përdoruesit e burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike nëpërmjet këtij mekanizmi do të përdoren për të mbështetur ruajtjen e diversitetit biologjik dhe përdorimin e qëndrueshëm të komponentëve të tij në mënyrë globale.

Neni 11

Bashkëpunimi transkufitar

1. Në rastet kur të njëjtat burime gjenetike gjenden në vendin fillestar brenda territorit të më shumë se një pale, këto palë do të përpiqen të bashkëpunojnë, si të jetë e përshtatshme, me përfshirjen e komuniteteve indigjene dhe vendore të interesuara, aty ku është e aplikueshme, me synimin për të zbatuar këtë protokoll.

2. Aty ku njohuritë tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike ndahen nga një ose më shumë komunitete indigjene dhe vendore në disa palë, këto palë do të përpiqen të bashkëpunojnë, si të jetë e përshtatshme, në përfshirjen e komuniteteve indigjene dhe vendore të interesuara, me synimin për të realizuar objektivin e këtij protokollit.

Neni 12

Njohuritë tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike

1. Në implementimin e detyrimeve të tyre sipas këtij protokollit, palët në përputhje me ligjin e brendshëm do të marrin në konsideratë ligjet e zakonshme të komuniteteve indigjene dhe vendore, protokollet dhe procedurat e komunitetit, si të jetë e aplikueshme në lidhje me njohuritë tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike.

2. Palët me pjesëmarrjen efektive të komuniteteve indigjene dhe vendore të interesuara, do të vendosin mekanizma për të informuar përdoruesit potencialë të njohurive tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike për detyrimet e tyre, duke përfshirë masat që vihen në dispozicion nëpërmjet Zyrës Qendrore të Aksesit dhe Ndarjes së Përfitimit për aksesin dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i këtyre njohurive.

3. Palët do të përpiqen të mbështesin, si të jetë e përshtatshme, krijimin nga ana e komuniteteve indigjene dhe vendore, duke përfshirë gratë brenda këtyre komuniteteve:

a) të protokolleve të komunitetit në lidhje me aksesin në njohuritë tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i këtyre njohurive;

b) të kërkesave minimale për termat e rënë dakord në mënyrë reciproke për të siguruar ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që lindin nga përdorimi i njohurive tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike; dhe

c) Klauzolat kontraktuale model për ndarjen e përfitimit që lind nga përdorimi i njohurive tradicionale të shoqëruara me burime gjenetike.

4. Në implementimin e këtij protokollit, aq sa të jetë e mundur, palët nuk do të kufizojnë përdorimin dhe shkëmbimin e zakonshëm të burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale të shoqëruara brenda dhe midis komuniteteve indigjene dhe vendore në përputhje me objektivat e konventës.

Neni 13

Pikat kombëtare të fokusit dhe autoritetet kompetente kombëtare

1. Secila palë do të përcaktojë një pikë kombëtare fokusi për aksesin dhe ndarjen e përfitimit. Pika kombëtare e fokusit do të vërë në dispozicion informacionin si më poshtë:

a) Për aplikantët që kërkojnë akses në burimet gjenetike, informacion për procedurat për marrjen e pëlqimit paraprak të informuar dhe vendosjen e termave për të cilët bihet dakord në mënyrë reciproke, duke përfshirë ndarjen e përfitimit;

b) Për aplikantët që kërkojnë akses në njohuritë tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike, aty ku është e mundur, informacion për procedurat për marrjen e pëlqimit ose të miratimit paraprak të informuar dhe përfshirjen, si të jetë e përshtatshme, të komuniteteve indigjene dhe vendore dhe vendosjen e termave për të cilët është rënë dakord në mënyrë reciproke duke përfshirë ndarjen e përfitimit; dhe

c) Informacion për autoritetet kombëtare kompetente, komunitetet përkatëse indigjene dhe vendore dhe aktorët përkatës.

Pika kombëtare e fokusit do të përgjigjet për marrëdhëniet me sekretariatit.

2. Secila palë do të përcaktojë një ose më shumë autoritete kombëtare kompetente për aksesin dhe ndarjen e përfitimit. Autoritetet kombëtare kompetente në përputhje me masat e aplikueshme kombëtare legjislative, administrative apo politike do të përgjigjen për dhënien e aksesit ose, si të jetë e aplikueshme, për lëshimin e provave me shkrim që të plotësohen kërkesat e aksesit dhe do të përgjigjen



për këshillimin për procedurat dhe kërkesat e aplikueshme për marrjen e pëlqimit paraprak të informuar dhe futjen në termat për të cilët është rënë dakord në mënyrë reciproke.

3. Një palë mund të përcaktojë një ent të vetëm për të përmbushur funksionet si të pikës së fokusit edhe të autoritetit kombëtar kompetent.

4. Secila palë jo më vonë se data e hyrjes në fuqi të këtij protokollit për të, do të njoftojë sekretariatit për informacionin e kontaktit të pikës së saj kombëtare të fokusit dhe të autoritetit ose autoriteteve kombëtare kompetente të saj. Aty ku një palë përcakton më tepër se një autoritet kompetent kombëtar, ajo do t'i kalojë sekretariatit me njoftimin për këtë, informacionin përkatës për përgjegjësitë përkatëse të këtyre autoriteteve. Aty ku është e aplikueshme, ky informacion, në mënyrë minimale, do të specifikojë se cili autoritet kompetent përgjigjet për burimet gjenetike të kërkuara. Secila palë do të njoftojë menjëherë sekretariatit për ndonjë ndryshim në përcaktimin e pikës kombëtare të fokusit ose në informacionin e kontaktit ose përgjegjësitë e autoritetit ose autoriteteve kombëtare kompetente.

5. Informacionin e marrë sipas paragrafit 4 më sipër sekretariati do ta vërë në dispozicion nëpërmjet Zyrës Qendrore.

Neni 14

Aksesi, zyra qendrore e ndarjes së përfitimit dhe ndarja e informacionit

1. Krijohet me këtë akt një zyrë qendrore për aksesin dhe ndarjen e përfitimit si pjesë e mekanizmit të Zyrës Qendrore sipas nenit 18, paragrafi 3 i konventës. Ajo do të shërbejë si një mjet për shpërndarjen e informacionit që lidhet me aksesin dhe ndarjen e përfitimit. Në veçanti, ajo do të garantojë aksesin në informacion të vënë në dispozicion nga secila palë në lidhje me implementimin e këtij protokollit.

2. Pa paragjykuar mbrojtjen e informacionit konfidencial, secila palë duhet të vërë në dispozicion të Zyrës Qendrore të Aksesit dhe Ndarjes së Përfitimit çdo informacion që kërkohet nga ky protokoll, si dhe informacionin e kërkuar sipas vendimeve të marra nga konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll. Informacioni do të përfshijë:

a) Masat legjislative, administrative dhe politike për aksesin dhe ndarjen e përfitimit;

b) Informacion për pikën kombëtare të fokusit dhe autoritetin ose autoritetet kombëtare kompetente; dhe

c) Lejet ose ekuivalentin e tyre të lëshuar në kohën e aksesit si pronë e vendimit për të dhënë pëlqimin e informuar paraprak dhe për vendosjen e termave për të cilët është rënë dakord në mënyrë reciproke.

3. Informacioni shtesë, në qoftë se disponohet dhe si të jetë e përshtatshme, mund të përfshijë:

a) Autoritetet kompetente përkatëse të komuniteteve indigjene dhe vendore dhe informacionin që vendoset në këtë mënyrë;

b) Klauzolat kontraktuale model;

c) Metodat dhe mjetet e zhvilluara për të monitoruar burimet gjenetike; dhe

d) Kodet e sjelljes dhe praktikat më të mira.

4. Modalitetet e operimit të Zyrës Qendrore të Aksesit dhe Ndarjes së Përfitimit, duke përfshirë raportet mbi aktivitetet e saj, do të konsiderohen dhe vendosen nga konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll në takimin e saj të parë dhe do të mbahet në rishikim më pas.

Neni 15

Përputhja me legjislacionin ose kërkesat rregullatore të brendshme për aksesin dhe ndarjen e përfitimit

1. Secila palë do të marrë masat e përshtatshme, efektive dhe proporcionale legjislative, administrative ose politike për të garantuar që burimet gjenetike të përdorura brenda juridiksionit të saj kanë pasur akses në përputhje me pëlqimin paraprak të informuar dhe se janë vendosur termat për të cilët është rënë dakord në mënyrë reciproke, siç kërkohet nga legjislacioni apo kërkesat rregullatore të brendshme për aksesin dhe ndarjen e përfitimit të palës tjetër.

2. Palët do të marrin masa të përshtatshme, efektive dhe proporcionale për të trajtuar situatat e mospërputhjes me masat e miratuara në përputhje me paragrafin 1 më sipër.

3. Palët për aq sa është e mundur dhe e përshtatshme, do të bashkëpunojnë në çështjet e shkeljeve të pretenduara të legjislacionit apo kërkesave rregullatore të brendshme për aksesin dhe ndarjen e përfitimit që përmenden në paragrafin 1 më sipër.

Neni 16

Përputhja me legjislacionin ose kërkesat rregullatore të brendshme për aksesin dhe ndarjen e përfitimit për njohuritë tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike

1. Secila palë do të marrë masat e përshtatshme, efektive dhe proporcionale legjislative, administrative ose politike, si të jetë e përshtatshme, për të garantuar që njohuritë tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike të përdorura brenda juridiksionit të tyre të kenë akses në përputhje me pëlqimin ose miratimin paraprak të informuar dhe përfshirjen e komuniteteve indigjene ose vendore dhe që të jenë vendosur termat për të cilët është rënë dakord në mënyrë reciproke, siç kërkohet nga legjislacioni ose kërkesat rregullatore të brendshme për aksesin dhe ndarjen e përfitimit të palës tjetër, ku ndodhen këto komunitete indigjene dhe vendore, janë të vendosur.

2. Secila palë do të marrë masat e përshtatshme, efektive dhe proporcionale për të trajtuar situatat e mospërputhjes me masat e miratuara në përputhje me paragrafin 1 më sipër.

3. Palët, për aq sa është e mundur dhe e përshtatshme, do të bashkëpunojnë në çështjet e shkeljes së pretenduar të legjislacionit ose kërkesave rregullatore të brendshme për aksesin dhe ndarjen e përfitimit që përmenden në paragrafin 1 më sipër.

Neni 17

Monitorimi i përdorimit të burimeve gjenetike

1. Për të mbështetur përputhjen, secila palë do të marrë masa, si të jetë e përshtatshme, për të monitoruar dhe rritur transparencën për përdorimin e burimeve gjenetike. Këto masa do të përfshijnë:

a) Përcaktimin e një ose më shumë pikave të kontrollit, si më poshtë:

i) Pikat e kontrollit të përcaktuara do të mbledhin ose merrnin, si të jetë e përshtatshme, informacionin përkatës në lidhje me pëlqimin paraprak të informuar, për prejardhjen e burimit gjenetik, për të përcaktuar termat e rënë dakord në mënyrë reciproke, dhe/ose për përdorimin e burimeve gjenetike, si të jetë e përshtatshme;

ii) Secila palë, si të jetë e përshtatshme dhe në varësi të karakteristikave të veçanta të një pike kontrolli të përcaktuar, do të kërkojë përdorues të burimeve gjenetike për të dhënë informacionin e specifikuar në paragrafët më sipër në pikën e kontrollit të përcaktuar. Secila palë do të marrë masat e përshtatshme, efektive dhe proporcionale për të trajtuar situatat e mospërputhjes;

iii) Ky informacion, duke përfshirë atë nga certifikatat e njohura në mënyrë ndërkombëtare aty ku janë të disponueshme, pa paragjykuar mbrojtjen e informacionit konfidencial, do t'u jepet autoriteteve përkatëse kombëtare, palës që jep pëlqim paraprak të informuar dhe Zyrës Qendrore për Aksesin dhe Ndarjen e Përfitimit, si të jetë e përshtatshme;

iv) Pikat e kontrollit duhet të jenë efektive dhe duhet të kenë funksionet përkatëse për implementimin e këtij nënparagrafi (a). Ato duhet të lidhen me përdorimin e burimeve gjenetike ose të mbledhjes së informacionit përkatës, mes të tjerash, në çdo etapë të kërkimit, zhvillimit, novacionit, parakomercializimit ose komercializimit.

b) Inkurajimi i përdoruesve dhe ofruesve të burimeve gjenetike për të përfshirë dispozitat në termat e rënë dakord reciprokisht për të ndarë informacionin mbi implementimin e këtyre termave, duke përfshirë edhe nëpërmjet kërkesave për raportim; dhe

c) Inkurajimin e përdorimit të mjeteve dhe sistemeve të komunikimit me kosto efektive.

2. Një leje ose ekuivalenti i saj i lëshuar në përputhje me nenin 6, paragrafi 3 (e) dhe që vihet në dispozicion të Zyrës Qendrore të Aksesit dhe Ndarjes së Përfitimit, do të përbëjë një certifikatë përputhjeje të njohur ndërkombëtarisht.



3. Një certifikatë përputhjeje e njohur ndërkombëtarisht do të shërbejë si provë që aksesin në burimin gjenetik, që ajo mbulon, ka qenë në përputhje me pëlqimin e informuar paraprakisht dhe që termat e rënë dakord reciprokisht janë vendosur, siç kërkohet nga legjislacioni ose kërkesat rregullatore të brendshme për aksesin dhe ndarjen e përfitimit të palës që jep pëlqimin e informuar paraprak.

4. Certifikata e njohur ndërkombëtarisht e përputhjes do të përmbajë informacionin minimal të mëposhtëm kur nuk është konfidencial:

- a) autoriteti lëshues;
- b) data e lëshimit;
- c) ofruesi;
- d) identifikuesi unik i certifikatës;
- e) personi ose enti të cilit i është dhënë pëlqimi paraprak i informuar;
- f) lënda ose burimet gjenetike të mbuluara nga certifikata;
- g) konfirmimi që termat e rënë dakord reciprokisht janë vendosur;
- h) konfirmimi që pëlqimi i informuar paraprak është marrë; dhe
- i) përdorimi komercial dhe/ose jokomercial.

Neni 18

Përputhja me termat e rënë dakord reciprokisht

1. Në implementimin e nenit 6, paragrafi 3 (g) (i) dhe nenit 7, secila palë do të inkurajojë ofruesit dhe përdoruesit e burimeve gjenetike dhe/ose njohurive tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike që të përfshijnë dispozitat në termat e rënë dakord reciprokisht për të mbuluar, aty ku është e përshtatshme, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duke përfshirë:

- a) juridiksionin të cilit do t'ia nënshtrojnë çdo proces për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- b) ligjin e aplikueshëm; dhe/ose
- c) opsionet për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjes, të tilla si ndërmjetësimi ose arbitrazhi.

2. Secila palë do të sigurojë që të ekzistojë mundësia për të kërkuar rekurs në sistemet e tyre ligjore, në përputhje me kërkesat e aplikueshme juridiksionale, në rastet e lindjes së mosmarrëveshjeve nga termat e rënë dakord reciprokisht.

3. Secila palë do të marrë masa efektive, si të jetë e përshtatshme, në lidhje me:

a) aksesin në drejtësi; dhe

b) përdorimin e mekanizmave në lidhje me njohjen reciproke dhe zbatimin e gjykimeve të huaja dhe vendimeve të arbitrazhit.

4. Efektiviteti i këtij neni do të rishikohet nga konferenca e palëve që shërben si mbledhja e palëve në këtë protokoll në përputhje me nenin 31 të këtij protokoll.

Neni 19

Klauzolat kontraktuale model

1. Secila palë do të inkurajojë, si të jetë e përshtatshme, zhvillimin, përditësimin dhe përdorimin e klauzolave kontraktuale model për sektorin dhe midis sektorëve për termat e rënë dakord reciprokisht.

2. Konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll do të shënojë periodikisht përdorimin e klauzolave kontraktuale model për sektorin dhe midis sektorëve.

Neni 20

Kodet e sjelljes, udhëzimet dhe praktikat më të mira dhe/ose standardet

1. Secila palë do të inkurajojë si të jetë e përshtatshme, zhvillimin, përditësimin dhe përdorimin e kodeve vullnetare të sjelljes, udhëzimeve dhe praktikave më të mira dhe/ose standardet në lidhje me aksesin dhe ndarjen e përfitimit.

2. Konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll do të shënojë periodikisht përdorimin e kodeve vullnetare të sjelljes, udhëzimin dhe praktikave më të mira dhe/ose standardeve dhe do të konsiderojë miratimin e kodeve të sjelljes, udhëzimeve dhe praktikave më të mira dhe/ose standardeve specifike.

Neni 21

Rritja e ndërgjegjësimit

Secila palë do të marrë masa për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike dhe çështjet e aksesit dhe të ndarjes të përfitimit që lidhen me to. Këto masa mund të përfshijnë, mes të tjerash:

- a) promovimin e këtij protokollit, duke përfshirë objektivin e tij;
- b) organizimin e mbledhjeve të komuniteteve indigjene dhe vendore dhe aktorëve përkatës;
- c) krijimin dhe mbajtjen e një zyre ndihme për komunitetet indigjene dhe vendore dhe aktorëve përkatës;
- d) shpërndarja e informacionit nëpërmjet një zyre qendrore kombëtare;
- e) promovimi i kodeve të sjelljes, udhëzimeve dhe praktikave më të mira dhe/ose standardeve vullnetare në konsultim me komunitetet indigjene dhe vendore dhe aktorët përkatës;
- f) promovimi, si të jetë e përshtatshme, i shkëmbimeve të përvojave të brendshme, rajonale dhe ndërkombëtare;
- g) arsimim dhe trajnim i përdoruesve dhe ofruesve të burimeve gjenetike dhe njohurive tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike për detyrimet e tyre për aksesin dhe ndarjes së përfitimit;
- h) përfshirja e komuniteteve indigjene dhe vendore dhe aktorët përkatës në implementimin e këtij protokollit; dhe
- i) rritja e ndërgjegjshmërisë për protokollin dhe procedurat komunitare të komuniteteve indigjene dhe vendore.

Neni 22

Kapaciteti

1. Palët do të bashkëpunojnë për ndërtimin e kapacitetit, zhvillimin e kapacitetit dhe forcimin e burimeve njerëzore dhe kapaciteteve institucionale për të zbatuar në mënyrë efektive këtë protokoll te palët e vendeve në zhvillim, në veçanti në vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet në zhvillim të ishujve të vegjël mes tyre, dhe palët me ekonomi në tranzicion, edhe nëpërmjet përfshirjes së institucioneve dhe organizatave ekzistuese globale, rajonale, nënrajonale dhe kombëtare. Në këtë kontekst, palët duhet të lehtësojnë përfshirjen e komuniteteve indigjene dhe vendore dhe aktorëve përkatës, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe sektorin privat.

2. Nevoja e palëve të vendeve në zhvillim, në veçanti vendet më pak të zhvilluara të shteteve në zhvillim të ishujve të vegjël mes tyre, dhe palëve me ekonomi në tranzicion për burimet financiare në përputhje me dispozitat përkatëse të konventës për ndërtimin e kapacitetit dhe zhvillimin për të zbatuar këtë protokoll.

3. Si bazë për masat e duhura në lidhje me implementimin e këtij protokollit, palët e vendit në zhvillim, në veçanti të vendeve më pak të zhvilluara dhe shteteve në zhvillim të ishujve të vegjël mes tyre, palët me ekonomi në tranzicion duhet të identifikojnë nevojat dhe prioritetet e kapacitetit të tyre kombëtar nëpërmjet vetëvlerësimeve të kapacitetit kombëtar. Duke e bërë këtë, këto palë duhet të mbështesin nevojat dhe prioritetet për kapacitete të komuniteteve indigjene dhe vendore dhe aktorëve përkatës, siç do të identifikohen prej tyre, duke theksuar nevojat dhe prioritetet e kapaciteteve të grave.

4. Në mbështetje të implementimit të këtij protokollit, ndërtimi i kapacitetit dhe zhvillimi mund të trajtojnë mes të tjerash këto fusha kyçe:

- a) kapacitetin për të zbatuar dhe për t'iu përmbajtur detyrimeve të këtij protokollit;
- b) kapacitetin për të negociuar termat e rënë dakord reciprokisht;



c) kapacitetin për të zhvilluar dhe për të zbatuar masat e brendshme legislative, administrative ose politike për aksesin dhe ndarjen e përfitimit; dhe

d) kapacitetin e vendeve për të zhvilluar aftësitë e tyre endogjene të kërkimit për t'u shtuar vlerë burimeve të tyre gjenetike.

5. Masat në përputhje me paragrafin 1 deri 4 më sipër mund të përfshijnë, mes të tjerash:

a) zhvillimin ligjor dhe institucional;

b) promovimin e barazisë dhe drejtësisë në negociata, të tilla si trajnimi për të negociuar termat e rënë dakord reciprokisht;

c) monitorimin dhe zbatimin e përputhjes;

d) përdorimi i mjeteve më të mira në dispozicion dhe sistemeve të bazuar tek interneti për aktivitetet e aksesit dhe ndarjes së përfitimit;

e) zhvillimi dhe përdorimi i metodave të vlerësimit;

f) eksplorimet bio, kërkimi i lidhur me të dhe studimet taksonomike;

g) transferimi i teknologjisë dhe aftësia e infrastrukturës dhe teknike për ta bërë këtë transferim të teknologjisë të qëndrueshëm;

h) rritja e kontributit të aktiviteteve të aksesit dhe ndarjes së përfitimit për ruajtjen e diversitetit biologjik dhe përdorimit të qëndrueshëm të komponentëve të tij;

i) masat e veçanta për të rritur kapacitetin e aktorëve përkatës në lidhje me aksesin dhe ndarjen e përfitimit; dhe

j) masat e veçanta për të rritur kapacitetin e komuniteteve indigjene dhe vendore me theks te rritja e kapacitetit të grave brenda këtyre komuniteteve në lidhje me aksesin në burimet gjenetike dhe/ose njohuritë tradicionale të shoqëruara me burimet gjenetike.

6. Informacioni për ndërtimin e kapacitetit dhe iniciativave të zhvillimit në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombe, të marra përsipër në përputhje me paragrafët 1 deri 5 më sipër, duhet t'i jepen Zyrës Qendrore të Aksesit dhe Ndarjes së Përfitimit me synimin për të promovuar sinergjinë dhe koordinimin në ndërtimin e kapacitetit dhe zhvillimit për aksesin dhe ndarjen e përfitimit.

Neni 23

Transferimi i teknologjisë, bashkëpunimi dhe bashkëveprimi

Në përputhje me nenet 15, 16, 18 dhe 19 të konventës, palët do të bashkëpunojnë dhe bashkëveprojnë në programet e kërkimit dhe zhvillimit teknik dhe shkencor, duke përfshirë aktivitetet e kërkimit bioteknologjik, si mjete për të arritur objektivin e këtij protokoll. Palët marrin përsipër të promovojnë dhe inkurajojnë aksesin në teknologji me transferimin e teknologjisë te palët e vendeve në zhvillim, në veçanti vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet në zhvillim të ishujve të vegjël mes tyre, dhe palëve me ekonomi në tranzicion në mënyrë që të mundësohet zhvillimi dhe forcimi i një baze të shëndoshë dhe të suksesshme teknologjike dhe shkencore për arritjen e objektivave të konventës dhe këtij protokoll. Aty ku është e mundshme dhe e përshtatshme këto aktivitete bashkëpunuese duhet të kryhen në dhe me një palë ose disa palë që ofrojnë burime gjenetike që është vendi ose janë vendet e origjinës së këtyre burimeve ose një palë ose disa palë që i kanë përfituar burimet gjenetike në përputhje me këtë konventë.

Neni 24

Jopalët

Palët do të inkurajojnë jopalët që të anëtarësohen në këtë protokoll dhe të kontribuojnë me informacionin e duhur për Zyrën Qendrore të Aksesit dhe Ndarjes së Përfitimit.

Neni 25

Mekanizmi dhe burimet financiare

1. Në vlerësimin e burimeve financiare për implementimin e këtij protokoll, palët do të marrin parasysh dispozitat e nenit 20 të konventës.

2. Mekanizmi financiar i konventës do të jetë mekanizmi financiar për këtë protokoll.

3. Në lidhje me ndërtimin e kapacitetit dhe zhvillimin, të përmendur në nenin 22 të këtij protokoll, konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll, në dhënien e udhëzimeve në lidhje me mekanizmin financiar të përmendur në paragrafin 2 më sipër, për shqyrtim nga konferenca e palëve, do të marrë parasysh nevojën e palëve të vendeve në zhvillim, në veçanti vendet më pak të zhvilluara dhe shtetet në zhvillim të ishujve të vegjël mes tyre, dhe palëve me ekonomi në tranzicion, për burimet financiare, si dhe nevojat dhe prioritetet e kapaciteteve të komuniteteve indigjene dhe vendore, duke përfshirë gratë brenda këtyre komuniteteve.

4. Në kontestin e paragrafit 1 më sipër palët do të marrin parasysh gjithashtu nevojat e palëve të vendeve në zhvillim, në veçanti të vendeve më pak të zhvilluara dhe shteteve në zhvillim të ishujve të vegjël mes tyre dhe të palëve me ekonomi në tranzicion, në përpjekjet e tyre për të identifikuar dhe zbatuar ndërtimin e kapacitetit të tyre dhe kërkesat e zhvillimit për qëllimet e implementimit të këtij protokoll.

5. Udhëzimi për mekanizmin financiar të konventës në vendimet përkatëse të konferencës së palëve, duke përfshirë ato për të cilat është rënë dakord përpara miratimit të këtij protokoll, do të aplikohen, me ndryshimet përkatëse, në dispozitat e këtij neni.

6. Palët e vendit të zhvilluar gjithashtu mund të japin dhe palët e vendit në zhvillim dhe palët me ekonomi në tranzicion mund të përfitojnë nga burimet financiare dhe burimet e tjera për implementimin e dispozitave të këtij protokoll nëpërmjet kanaleve dypalëshe, rajonale dhe shumëpalëshe.

Neni 26

Konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll

1. Konferenca e palëve do të shërbejë si mbledhje e palëve në këtë protokoll.

2. Palët në konventë që nuk janë palë në këtë protokoll mund të marrin pjesë si vëzhgues në procedurat e ndonjë mbledhjeje të konferencës së palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll. Kur konferenca e palëve shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll, vendimet sipas këtij protokoll do të merren vetëm nga ata që janë palë në të.

3. Kur konferenca e palëve shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll, çdo anëtar i byrosë së konferencës së palëve që përfaqëson një palë në konventë por, në atë kohë, nuk është palë në këtë protokoll, do të zëvendësohen nga një anëtar që zgjidhet nga disa palë në këtë protokoll dhe prej tyre.

4. Konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll do të mbajë në rishikim të rregullt implementimin e këtij protokoll dhe brenda mandatit të tij do të marrë vendimet e domosdoshme për të promovuar implementimin e tij efektiv. Ajo do të kryejë funksionet e caktuara për të nga ky protokoll dhe:

a) do të bëjë rekomandime për çdo çështje të domosdoshme për implementimin e këtij protokoll;

b) do të krijojë organet vartëse që konsiderohen të nevojshme për implementimin e këtij protokoll;

c) do të kërkojë dhe do të përdorë aty ku duhet shërbimet dhe bashkëpunimin dhe informacionin që jepet nga organizatat ndërkombëtare kompetente dhe organet ndërqeveritare dhe joqeveritare;

d) do të krijojë formularin dhe intervalet për transmetimin e informacionit që do të dorëzohet në përputhje me nenin 29 të këtij protokoll dhe do ta konsiderojë këtë informacion, si dhe raportet e paraqitura nga ndonjë organ vartës;

e) do të konsiderojë dhe do të miratojë, si të kërkohet, amendamentet e këtij protokoll dhe të aneksit të tij, si dhe ndonjë aneksi shtesë në këtë protokoll, që konsiderohen të nevojshëm për implementimin e këtij protokoll; dhe



f) do të ushtrojë funksione të tjera të tilla që mund të kërkohen për implementimin e këtij protokoll.

5. Rregullat e procedurës së konferencës së palëve dhe rregullat financiare të konventës do të zbatohen, me ndryshimet përkatëse, sipas këtij protokoll, me përjashtim të rastit kur vendosen ndryshe me konsensus nga konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll.

6. Mbledhja e parë e konferencës së palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll do të mbledhet nga sekretariati dhe do të mbahet në të njëjtën kohë me mbledhjen e parë të konferencës së palëve që planifikohet pas datës së hyrjes në fuqi të këtij protokoll. Mbledhjet pasuese të zakonshme të konferencës së palëve që shërbejnë si mbledhje e palëve në këtë protokoll do të mbahen në të njëjtën kohë me mbledhjet e zakonshme të konferencës së palëve, përjashtuar rastin kur vendoset ndryshe nga konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll.

7. Mbledhjet e jashtëzakonshme të konferencës së palëve që shërbejnë si mbledhje e palëve në këtë protokoll do të mbahen në kohë të tjera siç do të gjykohet e nevojshme nga konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll, ose me kërkesën me shkrim të ndonjë pale, me kushtin që brenda gjashtë muajsh nga kërkesa që u komunikohet palëve nga sekretariati, të mbështetet nga të paktën një e treta e palëve.

8. Kombet e Bashkuara, agjencitë e tyre të specializuara dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, si dhe ndonjë shtet anëtar i tyre ose vëzhgues në to jopalë në konventë mund të përfaqësohen si vëzhgues në mbledhjet e konferencës së palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll. Çdo organ ose agjenci, qoftë kombëtare ose ndërkombëtare, qeveritare ose joqeveritare, që është e kualifikuar në çështjet e mbuluara nga ky protokoll dhe që kanë informuar sekretariatit për dëshirën e tij që të përfaqësohet në një mbledhje të konferencës së palëve që shërben si mbledhje e palëve me këtë protokoll si një vëzhgues, mund të pranohet si i tillë, përjashtuar rasti kur kundërshtohet të paktën një e treta e palëve të pranishme. Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë nen, pranimi dhe pjesëmarrja e vëzhguesve do t'u nënshtrohet rregullave të procedurës siç përmendet në paragrafin 5 më sipër.

Neni 27

Organet vartëse

1. Çdo organ vartës i krijuar sipas kësaj konvente mund t'i shërbejë këtij protokoll, duke përfshirë një vendim të konferencës së palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll. Çdo vendim i tillë do të specifikojë detyrat që do të merren përsipër.

2. Palët në konventë që janë palët në këtë protokoll mund të marrin pjesë si vëzhgues në zhvillimin e çdo mbledhjeje të çdo organi të tillë. Kur një organ vartës i konventës shërben si organ vartës në këtë protokoll, vendime sipas këtij protokoll do të merren vetëm nga palët në këtë protokoll.

3. Kur një organ vartës i konventës ushtron funksionet e tij në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me këtë protokoll, çdo anëtar i byrosë së atij organi vartës që përfaqëson një palë në konventë por, në atë kohë, nuk është palë në këtë protokoll, do të zëvendësohet nga një anëtar që do të zgjidhet nga dhe prej palëve në këtë protokoll.

Neni 28

Sekretariati

1. Sekretariati i krijuar nga neni 24 i konventës do të shërbejë si sekretariat në këtë protokoll.

2. Neni 24, paragrafi 1 i konventës për funksionet e sekretariatit do të zbatohet me ndryshimet e bëra në këtë protokoll.

3. Kostot e shërbimeve të sekretariatit për këtë protokoll do të përballohen nga palët e tij deri në masën që janë të dallueshme. Konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll në mbledhjen e saj të parë do të vendosë për rregullimet e nevojshme buxhetore për këtë qëllim.

Neni 29

Monitorimi dhe raportimi

Secila palë do të monitorojë implementimin e detyrimeve të saj sipas këtij protokoll, dhe në intervale dhe formatin e përcaktuar nga konferenca e palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll, do t'i raportojë konferencës së palëve që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll për masat që ajo ka marrë për të zbatuar këtë protokoll.

Neni 30

Procedurat dhe mekanizmat për promovimin e përputhjes me këtë protokoll

Konferenca e palëve që shërben si mbledhja e palëve në këtë protokoll në mbledhjen e saj të parë, do të konsiderojë dhe do të miratojë procedurat bashkëvepruese dhe mekanizmat institucionalë për promovimin e përputhjes së dispozitave të këtij protokoll dhe do të trajtojë çështjet e mospërputhjes. Këto procedura dhe mekanizma do të përfshijnë dispozitat që ofrojnë këshilla dhe asistencë aty ku duhet. Ato do të jenë të veçanta nga dhe pa paragjykuar procedurat dhe mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas nenit 27 të konventës.

Neni 31

Vlerësimi dhe rishikimi

Konferenca e palëve që shërben si mbledhja e palëve në këtë protokoll do të marrë përsipër, katër vite pas hyrjes në fuqi të këtij protokoll dhe më pas në intervale të përcaktuara nga konferenca e palëve, që shërben si mbledhje e palëve në këtë protokoll, një vlerësim të efektivitetit të këtij protokoll.

Neni 32

Nënshkrimi

Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga palët në konventë në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, nga data 2 shkurt 2011 deri më 1 shkurt 2012.

Neni 33

Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit dhe aderimit nga shtetet ose organizatat rajonale të integritit ekonomik që janë palë në konventë.

2. Ky protokoll do të hyjë në fuqi për një shtet ose një organizatë rajonale të integritit ekonomik që ratifikon, pranon ose miraton këtë protokoll ose aderon në të pas depozitimit të instrumentit të pesëdhjetë siç përmendet në paragrafin 1 më sipër në ditën e nëntëdhjetë pas datës, në të cilin shteti ose organizata rajonale e integritit ekonomik depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ose në datën në të cilën konventa hyn në fuqi për atë shtet ose atë organizatë rajonale të integritit ekonomik, cila të jetë më e vonë.

3. Për qëllimet e paragrafëve 1 dhe 2 më sipër, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik nuk do të llogaritet si shtesë në ato të depozituara nga shtetet anëtare të kësaj organizate.

Neni 34

Rezervat

Në këtë protokoll nuk mund të bëhen rezerva.



Neni 35 Tërheqja

1. Në çdo kohë, dy vjet pas datës në të cilën ka hyrë në fuqi ky protokoll për një palë, ajo palë mund të tërhiqet nga ky protokoll, duke i dhënë depozituesit një njoftim me shkrim.

2. Çdo tërheqje e tillë do të ndodhë me skadimin e vitit të parë pas datës së marrjes së saj nga depozituesi, ose në një datë të tillë më të vonë siç do të specifikohet në njoftimin e tërheqjes.

Neni 36 Tekstet autentike

Originali i këtij protokoll, për të cilin tekstet në arabisht, në gjuhën kineze, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht janë njëloj autentike, do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë gjë, kanë nënshkruar këtë protokoll në datat e treguara.

Bërë në Nagoja, sot në datën njëzet e nëntë tetor, dy mijë e dhjetë.

ANEKS PËRFITIMET MONETARE DHE JOMONETARE

1. Përfitimet monetare mund të përfshijnë por mund të mos kufizohen me:

a) pagesat/pagesën e aksesit për mostrën e mbledhur ose të përfituar ndryshe;

b) pagesat paraprake;

c) pagesat me faza;

d) pagesa për rentën;

e) pagesat e licencës në rast komercializimi;

f) pagesat e veçanta për t'u paguar fondeve *trust* që mbështesin ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit;

g) pagat dhe termat preferencialë aty ku bien dakord reciprokisht;

h) financimet e kërkimit;

i) ndërmarrjet e përbashkëta;

j) pronësinë e përbashkët e të drejtat përkatëse të pronësisë intelektuale.

2. Përfitimet jomonetare mund të përfshijnë por mund të mos kufizohen me:

a) ndarjen e rezultateve të kërkimit dhe zhvillimit;

b) bashkëpunimi, bashkëveprimi dhe kontributi në programet e kërkimit dhe të zhvillimit shkencor, veçanërisht aktivitetet e kërkimit bioteknologjik, ku është e mundur te pala që ofron burimet gjenetike;

c) pjesëmarrja në zhvillimin e produktit;

d) bashkëpunimi, bashkëveprimi dhe kontributi në arsim dhe trajnim;

e) pranimi i burimeve gjenetike dhe bazave të të dhënave në fasilitetet jashtë vendit;

f) transferimi tek ofruesi i burimeve gjenetike i njohurive të teknologjisë sipas termave të drejtë dhe më të favorëshëm, edhe me termat koncensionalë dhe preferencialë ku bihet dakord, në veçanti, njohuritë dhe teknologjia që përdorin burimet gjenetike, duke përfshirë bioteknologjinë, ose që kanë lidhje me ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të diversitetit biologjik;

g) forcimi i kapaciteteve për transferimin e teknologjisë;

h) ndërtimi i kapacitetit institucional;

i) burimet njerëzore dhe materiale për forcimin e kapaciteteve për administratën dhe zbatimin e rregullave të rregulloreve të aksesit;

j) trajnimi i lidhur me burimet gjenetike me pjesëmarrjen e plotë të vendeve që ofrojnë burimet gjenetike dhe aty ku është e mundur, në këto vende;

- k) aksesit në informacionin shkencor që lidhet me ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të diversitetit biologjik, duke përfshirë inventarët biologjikë dhe studimet taksonomike;
- l) kontributet në ekonominë vendore;
- m) kërkimi i drejtuar ndaj nevojave, të tilla si shëndeti dhe siguria e ushqimit, duke marrë parasysh përdorimet e brendshme të burimeve gjenetike në palën që ofron burimet gjenetike;
- n) marrëdhëniet institucionale dhe profesionale që mund të lindin nga një akses dhe marrëveshje për ndarjen e përfitimit dhe aktivitetet bashkëpunuese pasuese;
- o) përfitimet e ushqimit dhe sigurisë së jetesës;
- p) njohja sociale;
- q) pronësia e përbashkët e të drejtave të pronës intelektuale.

LIGJ
Nr. 114/2012

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9936, DATË 26.6.2008 “PËR MENAXHIMIN E
SISTEMIT BUXHETOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 157 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, bëhet ky ndryshim:

Neni 1

Paragrafi i fundit i nenit 58 shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.12.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7861, datë 17.12.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



VENDIM
Nr. 47/2012

PËR NUMËRTIMIN E LEGJISLATURAVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Numërtimi i legjislatrave të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë fillon prej Legjislaturës së Parë, e mbledhur në datën 15.4.1991, dhe vazhdon me legjislatrat pasardhëse, sipas aneksit I bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Legjislatrat parlamentare, prej krijimit të shtetit shqiptar deri në vitin 1991, renditen sipas aneksit II të këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 15.11.2012

ANEKSI I

Legjislatrat e Kuvendit të Shqipërisë

15.4.1991 – 4.2.1992	Legjislatra	I
4.4.1992 – 29.3.1996	Legjislatra	I
1.7.1996 – 15.5.1997	Legjislatra	III
23.7.1997 – 17.5.2001	Legjislatra	IV
3.9.2001 – 20.5.2005	Legjislatra	V
2.9.2005 – 28.5.2009	Legjislatra	VI
6.9.2009	Legjislatra	VII

ANEKSI II

LEGJISLATURAT PARLAMENTARE NË SHQIPËRI PREJ KRIJIMIT TË SHTETIT
SHQIPTAR DERI NË VITIN 1991

(Datat e shënuara janë datat e mbledhjeve të para dhe të fundit të secilës legjislaturë)

27.3.1920- 20.12.1920	Këshilli Kombëtar i Lushnjës - Senati
21.4.1921 – 30.9.1923	Këshilli Kombëtar (Parlamenti)
21.1.1924 - 2.6.1924	Kuvendi Kushtetues (Periudha I)
12.1.1925 - 2.3.1925	Dhoma e Deputetëve dhe Senati (Periudha II)

REPUBLIKA SHQIPTARE

1.6.1925 – 7.6.1928	Legjislatura I: Dhoma e Deputetëve Senati
25.8.1928 – 1.12.1928	Asambleja Kushtetuese

MBRETËRIA SHQIPTARE

10.12.1928 – 11.5.1932	Legjislatura I
21.11.1932 – 16.11.1936	Legjislatura II
10.2.1937 – 5.4.1939	Legjislatura III

PERIUDHA E PUSHTIMIT TË SHQIPËRISË GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

12.4.1939 - 3.4.1940	Asambleja Kushtetuese
16.4.1940 – 31.7.1943	Këshilli i Epërm Korporativ Fashist
16.10.1943 – 10.11.1943	Asambleja Kombëtare
11.11.1943 – 14.9.1944	Kuvendi Kombëtar – Parlamenti
26.5.1944 – 2 .12.1945	Këshilli Antifashist Nacional Çlirimtar

LEGJISLATURAT E KUVENDIT POPULLOR NË REPUBLIKËN POPULLORE (DHE SOCIALISTE) TË SHQIPËRISË

10.1.1946 – 16.3.1946	Asambleja Kushtetuese
25.3.1946 – 21.1.1950	Legjislatura I
28.6.1950 – 14.4.1954	Legjislatura II
19.7.1954 – 21.2.1958	Legjislatura III
21.6.1958 – 3.6.1962	Legjislatura IV
14.7.1962 – 12.3.1966	Legjislatura V
19.9.1966 – 4.5.1970	Legjislatura VI
20.11.1970-19.6.1974	Legjislatura VII
28.10.1974 – 21.2.1978	Legjislatura VIII
25.12.1978 – 14.7.1982	Legjislatura IX
22.11.1982 – 10.1.1987	Legjislatura X
19.2.1987 – 13.11.1990	Legjislatura XI

VENDIM Nr. 48/2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 3, DATË 16.9.2009 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, në pikën I bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Auron Tare caktohet anëtar në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Deputeti Bedri Hoxha caktohet anëtar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare në vend të deputetit Gazmend Oketa.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 22.11.2012

VENDIM
Nr. 49/2012

MBI DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT ADRIATIK LLALLA PROKUROR I PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të neneve 78 e 149 pika 1 të Kushtetutës, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të dekretit nr. 7840, datë 3.12.2012 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Adriatik Llalla Prokuror i Përgjithshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miraturar në datën 7.12.2012

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 18.12.2012
Doli nga shtypi më 19.12.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 36 lekë